

VENDIM
Nr.408, datë 9.6.2005

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT ME KONCESION TË FORMËS
“BOO” TË HIDROCENTRALEVE STRANIK DHE ZALL-TORE, NË KOMUNËN
STRAVAJ, LIBRAZHD, SI PROPOZIM I PAKËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 4, 5 e 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës “BOO” (ndërtim, pronësi, shfrytëzim) të hidrocentraleve Stranik dhe Zall-Tore, në komunën Stravaj, Librazhd si propozim i pakërkuar, nga shoqëria “Hidroinvest” sh.p.k. Çarshovë, Përmet.

2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të jenë Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA), për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes koncesionare.

3. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano